



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

Në bazë të nenit 19, paragrafit (2), pikës 12, neneve 40 dhe 94 të Ligjit për arsimin e lartë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 82/2018 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut", nr. 178/2021), Rregullores për standardet dhe procedurën e vlerësimit të jashtëm dhe vetëvlerësimit ("Gazeta Zyrtare e RMV-së", nr. 153/2022), si dhe nenit 12, paragrafit (1), pikës 3, nenit 45, paragrafit (2), pikës 12 dhe nenit 85, paragrafit (1), pikës 31 të Statutit të Universitetit të Tetovës, Senati i Universitetit të Tetovës, në mbledhjen e mbajtur më 24.11.2022, miratoi këtë:

UDHËZUES

**për sigurimin dhe avancimin e cilësisë
në Universitetin e Tetovës**

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë Udhëzues rregullohen mënyra, procedurat dhe veprimtaritë për sigurimin dhe avancimin e cilësisë në Universitetin e Tetovës (në tekstin e mëtejshëm: Universiteti) dhe në njësitë përbërëse të tij, në përputhje me standardet, kriteret dhe treguesit e përcaktuar të cilësisë.

II. VETËVLERËSIMI

Neni 2

- (1) Vetëvlerësimi përbën segmentin themelor të sistemit për sigurimin dhe avancimin e cilësisë në Universitet dhe në njësitë përbërëse të tij.
- (2) Vetëvlerësimi zbatohet në mënyrë sistematike dhe periodike, në bazë të standardeve, kritereve dhe treguesve të përcaktuar të cilësisë, me qëllim përcaktimin e shkallës së përmbushjes së kërkesave, identifikimin e anëve të forta dhe fushave për përmirësim, si dhe ndërmarrjen e masave për avancimin e cilësisë.
- (3) Rezultatet e vetëvlerësimit shërbejnë si bazë për planifikimin, miratimin dhe monitorimin e masave dhe veprimtarive për sigurimin dhe avancimin e cilësisë.

III. BAZA PËR SIGURIMIN E CILËSISË DHE VLERËSIMIN

Neni 3

Sigurimi dhe avancimi i cilësisë, si dhe zbatimi i vetëvlerësimit dhe formave të tjera të vlerësimit të Universitetit dhe njësive përbërëse të tij, mbështeten në standardet dhe treguesit e



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

cilësisë të përcaktuar me Rregulloren për standardet dhe procedurën e vlerësimit të jashtëm dhe vetëvlerësimit dhe me Rregulloren për sigurimin dhe avancimin e cilësisë në Universitetin e Tetovës.

IV. ZBATIMI DHE MBËSHTETJA PROFESIONALE E VETËVLERËSIMIT

Neni 4

(1) Vetëvlerësimin e Universitetit dhe të njësive përbërëse të tij e zbatojnë Komisioni Qendror për Vetëvlerësim i Universitetit dhe komisionet për vetëvlerësim të fakulteteve, brenda kompetencave të tyre të përcaktuara me Rregulloren për sigurimin dhe avancimin e cilësisë në Universitetin e Tetovës.

(2) Mbështetjen profesionale dhe administrative për zbatimin e vetëvlerësimit të Universitetit dhe njësive përbërëse të tij e siguron Departamenti për Menaxhimin e Cilësisë dhe Vlerësim.

(3) Departamenti për Menaxhimin e Cilësisë dhe Vlerësim siguron mbështetje profesionale e metodologjike, koordinim dhe mbështetje administrative e teknike gjatë realizimit të veprimtarive që lidhen me vetëvlerësimin, në përputhje me Rregulloren për organizimin e brendshëm, Rregulloren për sigurimin dhe avancimin e cilësisë në Universitetin e Tetovës dhe këtë Udhëzues.

PËRCAKTIMI I PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE

Neni 5

(1) Përmbushja e standardeve të cilësisë në Universitet dhe në njësitë përbërëse të tij përcaktohet në bazë të treguesve të cilësisë të përcaktuar me Rregulloren për standardet dhe procedurën e vlerësimit të jashtëm dhe vetëvlerësimit, të miratuar nga Këshilli Kombëtar për Arsimin e Lartë.

(2) Gjatë përcaktimit të përmbushjes së standardeve merren parasysh të dhënat, dokumentet dhe dëshmitë e tjera përkatëse me të cilat vërtetohet përmbushja e treguesve përkatës.

VI. RAPORTI I VETËVLERËSIMIT

Neni 6

(1) Pas zbatimit të vetëvlerësimit hartohet raporti i vetëvlerësimit të Universitetit, përkatësisht i njësive përbërëse të tij.

(2) Raporti i vetëvlerësimit hartohet në bazë të formularit të përcaktuar me Rregulloren për standardet dhe procedurën e vlerësimit të jashtëm dhe vetëvlerësimit të Këshillit Kombëtar për Arsimin e Lartë dhe në përputhje me formularin e përcaktuar me Rregulloren për sigurimin dhe avancimin e cilësisë në Universitet.

(3) Përmbajtja dhe struktura e Raportit të vetëvlerësimit përcaktohen në përputhje me dispozitat nga paragrafi (2) i këtij neni.



(4) Raporti i vetëvlerësimit hartohet në gjuhën maqedonase dhe shqipe dhe përkthehet në gjuhën angleze.

VII. SHTOJCAT E RAPORTIT TË VETËVLERËSIMIT

Neni 7

- (1) Pjesë përbërëse e Raportit të vetëvlerësimit janë të dhënat, analizat dhe dëshmitë përkatëse, mbi bazën e të cilave është përcaktuar përmbushja e standardeve dhe treguesve të cilësisë.
- (2) Pjesë përbërëse e Raportit të vetëvlerësimit janë edhe rezultatet e anketave të studentëve për vlerësimin e cilësisë së personelit mësimor dhe bashkëpunëtor, si dhe rezultatet e anketave për vlerësimin e veprimtarisë mësimore.
- (3) Anketat nga paragrafi (2) i këtij neni zbatohen dhe përpunohen në përputhje me formularët dhe metodologjinë e përcaktuar me dispozitat nga neni 6, paragrafi (2), i këtij Udhëzuesi.
- (4) Mënyra e mbledhjes, përpunimit, analizimit dhe paraqitjes së rezultateve të anketave përcaktohet në përputhje me metodologjinë dhe mënyrën e punës të përcaktuar nga njësitë dhe Komisioni Qendror për Vetëvlerësim.

PUBLIKIMI I RAPORTIT TË VETËVLERËSIMIT

Neni 8

- (1) Raporti i vetëvlerësimit publikohet në faqen e internetit të Universitetit, përkatësisht të njësisë përbërëse të tij, në përputhje me Rregulloren për standardet dhe procedurën e vlerësimit të jashtëm dhe vetëvlerësimit të Këshillit Kombëtar për Arsimin e Lartë dhe Rregulloren për sigurimin dhe avancimin e cilësisë në Universitet.

ANKETAT PËR VLERËSIMIN E CILËSISË

Neni 9

- (1) Në kuadër të procedurës së vetëvlerësimit realizohen anketa për vlerësimin e cilësisë së personelit mësimor dhe bashkëpunëtor dhe anketa për vlerësimin e veprimtarisë mësimore.
- (2) Struktura, përmbajtja dhe mënyra e realizimit të anketave nga paragrafi (1) i këtij neni përcaktohen në përputhje me formularët dhe kërkesat e përcaktuara me Rregulloren për standardet dhe procedurën e vlerësimit të jashtëm dhe vetëvlerësimit të Këshillit Kombëtar për Arsimin e Lartë dhe Rregulloren për sigurimin dhe avancimin e cilësisë në Universitetin e Tetovës.



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ БО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

AFATET DHE MËNYRA E REALIZIMIT TË ANKETAVE

Neni 10

- (1) Afatet për realizimin e anketave i përcakton Komisioni Qendror për Vetëvlerësim.
- (2) Anketat realizohen në mënyrë që të sigurohen objektiviteti, anonimiteti dhe mbrojtja e të dhënave të pjesëmarrësve.
- (3) Anketat realizohen sipas mënyrës së përcaktuar nga Komisioni Qendror për Vetëvlerësim.

DETYRIMI PËR PLOTËSIMIN E ANKETAVE

Neni 11

- (1) Plotësimi i anketave nga neni 10, paragrafi (1), i këtij Udhëzuesi është i detyrueshëm për studentët e përfshirë në anketim.
- (2) Të dhënat dhe rezultatet e anketave përpunohen, analizohen dhe përdoren vetëm për qëllimet e sigurimit dhe avancimit të cilësisë, në përputhje me dispozitat që rregullojnë mbrojtjen e të dhënave personale.

VEPRIMI NË BAZË TË REZULTATEVE TË ANKETAVE

Neni 12

- (1) Rezultatet e anketave të realizuara analizohen dhe përdoren për përcaktimin e gjendjes, identifikimin e mangësive të mundshme dhe përcaktimin e nevojave për avancimin e cilësisë.
- (2) Në bazë të rezultateve të analizës, kur konstatohet nevoja, hartohet plan veprimi për ndërmarrjen e masave dhe veprimtarive për avancimin e cilësisë.

PËRMBAJTJA DHE MONITORIMI I PLANIT TË VEPRIMIT

Neni 13

- (1) Plan i veprimit nga neni 12, paragrafi (2), përmban masat dhe veprimtaritë, rezultatet e pritshme, afatet e realizimit, personat ose organet përgjegjëse dhe mënyrën e monitorimit të realizimit.
- (2) Realizimi i masave dhe veprimtarive të planit të veprimit monitorohet brenda afateve të përcaktuara, ndërsa rezultatet e monitorimit merren parasysht gjatë vlerësimit dhe vetëvlerësimit të radhës.
- (3) Plan i veprimit mund të jetë pjesë përbërëse e Strategjisë së Zhvillimit të Universitetit.



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 14

(1) Procedurat për sigurimin dhe avancimin e cilësisë, të filluara para hyrjes në fuqi të këtij Udhëzuesi, do të vazhdojnë në përputhje me dispozitat e tij, për aq sa kjo nuk ndikon në të drejtat dhe detyrimet e fituara të pjesëmarrësve në procedurë.

(2) Ky Udhëzues hyn në fuqi në ditën e miratimit të tij.



Kryetar i Senatit,
Prof. Dr. Vullnet Ameti